



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 336, datë 25.10.2021

**PËR CAKTIMIN E PROKURORIT NË POZICIONIN VAKANT NR. 1 NË
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË APELIT TIRANË SHPALLUR ME
VENDIMIN NR. 330, DATË 29.12.2020 TË KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË SIPAS PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 43 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 44 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”, si dhe në relacionin shpjegues të paraqitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Caktimin e Znj. **Arta Marku** në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, shpallur me Vendimin nr.330, datë 29.12.2020.
2. Të njoftohen për këtë vendim Znj. **Marku**, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi më datë 25.10.2021 dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR
GËNT IBRAHIMI**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR
VATË STAKA**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR
SANDËR BEGI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
MOISI DUDA**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**